

ZËRI "ALBANIA"

(Fjalori Enciklopedik nën redaktimin e prof. I. E. Andrejeiskit.

Botues: F.A. Broghaus (Laipsig), I. A. Jefron (Shën - Petërburg).

Viti i botimit: 1890 - Shën - Petërburg)

Ky material dëshmon se si Rusia e dinte që Shqipëria përfshinte përveç Shqipërisë së sotme edhe pjesët e marra nga Mali i Zi, Kosovën, Maqedoninë Perëndimore dhe të gjithë Epirin.

Albania është një emërtim i pjesës perëndimore dhe jugperëndimore të shteteve të Perandorisë Osmane në Europë. Duke përfshirë hapësirat e Epirit të lashtë dhe Ilirisë së vjetër, ajo (Shqipëria) zgjatet gjatë brigjeve të deteve Jon dhe Adriatik, nga gjiri i Artës deri në territoret që ndodhen përtej lumit Buna, duke filluar nga 39° deri në 42° gjerësi gjeografike. Në kufirin verior ndodhet një territor që i është dhënë Malit të Zi (Ulqini) dhe sanxhaku i Novi Pazarit, i pushtuar nga Austria në jug të gjirit të Artës dhe të Mbretërisë greke, prej të cilit Shqipëria, qysh nga koha e gllabërimit të tokave, më 1881, ndahet nëpërmjet lumit të Artës. Kufiri lindor mbetet i papërcaktuar, nëse merret parasysh parimi historik dhe përbërja e popullsisë, apo kufiri do të kalojë në mënyrë arbitrare sipas ndryshimeve të diktuar nga presioni i vilajeteve të Perandorisë Osmane, ku Shqipërisë i bashkëngjitet një pjesë e Thesalisë dhe Maqedonisë. Në rastin e parë, ky vend zë hapësirën prej 44.000 km² dhe në rastin e dytë 90.000 km². Pozicioni gjeografik nga ana e deteve (nga perëndimi) nuk është pa rëndësi. Atje ku ndodhet gjiri Gllosa (Gjuhëza), në Kanalën e Otrantos, i afrohet deri në 70 km brigjeve të përtejme të gadishullit Apenin, kështu që ajo përbën një hallkë natyrore midis Turqisë europiane dhe Italisë. Nga gjiri i Gjuhëzës - Gllosa deri në pikën më veriore dhe më jugore, që janë grykëderdhjet e Bunës dhe Prevezës, largësia është pothuajse e njëjlojtë (rreth 180 km). Kësaj ndarjeje të bregdetit në dy pjesë gati të barabarta

shqiptaro-adriatike dhe shqiptaro-jonike i përgjigjet edhe ndarja e brendshme në kontinent e vendit. Ajo përfaqëson degëzimin jugor të Alpeve Dinarike dhe Dalmate.

Ndërkohë, nga nyja e përbashkët – mali i Sharrit, 2600 m lartësi, degëzohet në drejtim lindor vargu i gjatë i Ballkaneve ose Hemusë në drejtim të drejtë nga veriu në jug vjen vargmali i Pindit (Meçovë) me lartësi 1600-2600 m me male të ndryshme të njohura për mitet e Thesalisë së lashtë.

Në vendet që ndodhen në afërsi të Gramozit dhe të Pindit, këto territore dallohen (ndryshojnë) aq shumë sa ndryshimi i theksuar midis Shqipërisë së Veriut dhe Shqipërisë së Jugut ka ndikim dhe në zhvillimin historik. Shqipëria e Veriut i përgjigjet Ilirisë së lashtë, e cila papritur kthehet në ultësirën bregdetare të detit Adriatik, thellësitë detare të të cilit, për hir të ndryshimeve të rrjedhjeve të sipërme të lumenjve, ndryshojnë vazhdimisht. Në këtë bregdet, veçanërisht në vendet afër grykëderdhjeve të Bunës, Drinit dhe Durrësit, është përhapur malaria, prandaj njerëzit nga fundi i verës zakonisht largohen nëpër male në rrethinat e liqenit të Ohrit (bëhet fjalë për verimin e bagëtive). Në dallim nga Shqipëria e Veriut, Shqipëria e Ulët (Jugore) (Epiri i vjetër) përbëhet nga shkëmbinj vullkanikë (gjë për të cilën flet emërtimi i vjetër i maleve të Himarës). Tërmetet ndodhin shpesh, megjithëse jo shumë të fortë. Malet janë të veçuar njëri nga tjetri me lugina të shumta, të cilat zbresin si thikë në drejtim të detit. Vetëm në afërsi të Filatit (karshi Korfuzit), në pikën më jugore të Prevezës takohen fusha.

Largësia jo fort e madhe, me anën e së cilës malet përbëjnë kufirin midis Shqipërisë, nga njëra anë, dhe Maqedonisë dhe Thesalisë, nga ana tjetër, duke formuar një ultësirë, që e merr fillimin nga detet Jon dhe Adriatik, ku është i zhvilluar shumë sistemi lumor, sidomos në Shqipërinë e Jugut. Në Shqipërinë e Veriut, lumi Drin përbëhet nga dy degë që vijnë nga Jugu, nga liqeni i Ohrit – Drini i Zi dhe dega që vjen nga veriu, nga Serbia – Drini i Bardhë.

Pak ura janë ndërtuar përgjatë lumenjve, niveli i ujit të të cilëve shpesh ngrihet dhe shkakton fatkeqësi në viset shqiptare. Në veri të Drinit, vetëm 22 km nga gryka, derdhet në Adriatik lumi Buna ose Moraça e Malit të Zi, i cili, kur del nga liqeni i

Shkodrës, merr emër të ri. Midis Drinit dhe Bunës ndodhet Drinasi.

Ish-Veziri i Madh, Esat Pasha, më 1869, duke qenë gjeneral dhe guvernator, bëri përpjekje të rregullonte rrjedhjen e Bunës, për ta bërë atë lundruese deri në Shkodër, duke ndërtuar një port. Punimet ecën mirë, por pastaj u ndërprejnë.

Nga lumenjtë e tjerë në Shqipërinë e Veriut mund të përmendim lumenjtë Mat, Erzen, Ishëm dhe Shkumbin. Në Shqipërinë e Jugut janë këta lumenj: Semani, Vjosa dhe Kalasa. Veç kësaj, në Veri ndodhet edhe një liqen i madh, liqeni i Shkodrës, pjesa më e madhe e të cilit i përket Malit të Zi, si dhe liqeni i Ohrit, të dy me gjatësi 27 km dhe gjerësi 10 km. Liqeni i Janinës në jug të Shqipërisë ka gjatësi 18 km, gjerësi 3.5 km. Klima, me përjashtim të bregdetit verior me laguna të shumta, është e nxehtë, e njëjtë me gjerësinë gjeografike të Italisë së Jugut. Klima kushtëzohet nga vendndodhja e luginave. Toka është e varfër, por po të punohet, jep prodhim të mirë (të bollshëm). Misri rritet si në Veri edhe në Jug. Duhani ka cilësi të mirë, përgjatë bregdetit shtrihen plantacionet me ullinj, që përbëjnë bazën kryesore të tregtisë. Malet dikur kanë qenë me drurë që përdorëshin për të ndërtuar anijet në kohën turke. Brenda vendit ndodhen pyje të dendur. Shumica e popullsisë merret me blegtori dhe më pak me bujqësi. Tregtia kryesore me Stambollin është ajo e lëkurëve dhe mishit të qengjit. Shiten edhe breshka dhe shushunja, të cilat gjejnë treg në Trieste. Shfrytëzimi i koraleve nga Ali Pashai dhe kripa në Vlorë. Popullsia nuk ka shumë dëshirë të përpunojë dhe të shfrytëzojë pasuritë natyrore.

Duhet vënë në dukje se armiku më i madh i Shqipërisë në ato kohëra ka qenë shteti rus, po japim një intervistë të ministrit të Jashtëm të Rusisë më 9 janar 1915, dhënë korrespondentit të Korriere de la sera (Corriere della sera) në Petërsburg. Për pushtimin e Vlorës, që kreu qeveria italiane, ministri i Jashtëm rus u shpreh kështu: "Përse flamuri italian valon përbri flamurit shqiptar? Për ne nuk ekziston shtet shqiptar. Shqipëria vdiq para se të jetojë. Ajo pati një periudhë qenieje të gënjeshtërt, gjë që unë e kisha parashikuar mirë. Unë nuk njoha elementët e gjallë të një shteti që nga kaosi legjendar shqiptar, prej tij nuk mund të dalë ndonjë send edhe sot, pas kësaj, nuk mund të kuptojmë si Italia kërkon prapë dhe pranon që flamuri i saj të ngrihet afër një

flamuri tjetër që është simbol i anarkisë politike". Fjalët e rrufeshme dhe vdekjeprurëse të ministrit rus për Shqipërinë janë, padyshim, për çdo shqiptar thika në mushkëri e në zemër.

Mbrojtësja e Shqipërisë, pa dyshim, ka qenë Austria dhe për Austrinë Konica na thotë këto fjalë lapidare: "Të mos ishte Austria, sllavët dhe grekët do ta merrnin për 24 orë Shqipërinë, se armiqtë tanë kanë ushtri të rregullt, oficerë me mjeshtëri dhe topa, ne trima veç e veç, s'kemi forcë fare si komb, sepse s'kemi bashkim, s'kemi armë mjaft, s'kemi njerëz për të drejtuar luftën. Frika e Austrisë i mban armiqtë tanë, ata që s'e kuptojnë këtë janë gomerë".